



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; site www.klsh.org.al

Nr. 489/5 Prot.

Tiranë, më 30.07.2018

V E N D I M

Nr. 97, Datë 30.07.2018

P Ë R

AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRINË TË USHTRUAR NË BASHKINË VAU I DEJËS për periudhën 01.01.2016 – 31.12.2017

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Vau i Dejës, “Mbi auditimin e rregullshmërisë financiare” për periudhën: Bashkia Vau-Dejës 01.01.2016 - 31.12.2017 dhe 5 ish-Komunat; Shllak, Temal, Vig-Mnelë, Hajmel dhe Bushat për periudhën 01.01.2013 -31.07.2015, rezultoi se në përgjithësi janë zbatuar aktet ligjore e nënligjore.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të rregullshmërisë financiare në Bashkinë Vau i Dejës, sipas programit të auditimit nr.489/1, date 02.05.2018, për veprimtarinë për Bashkia Vau-Dejës nga 01.01.2016 - 31.12.2017 dhe 5 ish-Komunat; Shllak, Temal, Vig-Mnelë, Hajmel dhe Bushat për periudhën 01.01.2013 -31.07.2015.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A- MASAT ORGANIZATIVE:

1.Gjetje nga auditimi: Nga administrata tatimore e bashkisë, Drejtoria e të Ardhurave nuk janë plotësuar njoftimet e detyrimit, nuk u janë dërguar në rrugë postare të gjithë subjekteve tatimpagues, që kanë detyrimin ligjor për të paguar, taksat dhe tarifave vendore si, për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, tarifën e ndriçimit, tarifën e gjelbërimit, taksën e tabelës dhe për taksën mbi ndërtesat dhe për pasojë nuk janë arkëtuar detyrimet ligjore nga subjektet taksapagues, veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 23, pika 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet 149 -150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave vendore të marrë masa në fillim të çdo viti buxhetor të plotësojë dhe të dërgojë njoftimet e detyrimeve në rrugë postare të gjithë subjekteve tatimpagues, ku të kërkojë arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Nga administrata tatimore e bashkisë, Drejtoria e të Ardhurave nuk është bërë miradministrimi i informacionit tatimor, të subjekteve tatimpagues të Biznesit të Vogël, për të gjitha detyrimet tatimore dhe nuk janë vendosur në dosjen e çdo tatim paguesi, ka mangësi përditësimi të të dhënave dhe mungesë të dokumentacionit, ku regjistrohen të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit, veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim, me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 29, pika 1 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet 160 - 164 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave vendore të marrë masa për gjatë vitit ushtrimor të plotësojë dosje të veçantë për çdo subjekt tatimpagues ku të administrojë të gjithë informacioni tatimor për të gjitha detyrimet dhe në vijimësi të kryej përditësimin e të dhënave për detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, pagesat interesat, gjobat që i takojnë tatimpaguesit.

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi: Nga administrata tatimore e bashkisë, Drejtoria e të Ardhurave nuk është vepruar për inventarizimin e dokumentacionit që ndodheshin në dosjet e subjekteve taksapagues të taksave dhe tarifave vendore ku nga auditimi u konstatuan me mangësi si të gjitha praktikant nuk shoqërohen me fletë inventari për numrin dhe llojin e dokumenteve dhe shkresave që përmban një dosje e subjektit, i gjithë dokumentacioni i subjektit mbahet në një dosje qysh nga krijimi i subjektit për disa vite me radhë, praktikant e përfunduara të viteve të mëparshëm nuk janë dorëzuar në arkivin e institucionit, në kundërshtim, me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” neni 24, dhe me Rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, kapitulli II, nenet 21,27 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet 149 -163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave vendore, të marrë masa për gjatë vitit ushtrimor të kryejnë inventarizimin e çdo dosje të veçantë për çdo subjekt tatimpagues për evidentimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, ku të plotësohet me fletë inventari i gjithë dokumentacioni që ka çdo subjekt tatimpagues.

Menjëherë

4.Gjetje nga auditimi: Nga punonjësit e ish Bashkisë Vau i Dejës, të ish Komunave Hajmel dhe Bushat, aktualisht Njësi Administrative të Bashkisë Vau-Dejës, me kryerjen e reformës administrative dhe kalimin e aktivitetit të bizneseve në Bashkinë e madhe Vau-Dejës, nuk kanë dorëzuar dhe nuk i kanë dokumentuar me procesverbal me komision, dokumentacionin e bizneseve si dosjet e bizneseve me ngarkesat e detyrimeve përkatëse, regjistrat e tatim

paguesve, pasqyrën e debitorëve të krijuar sipas viteve, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, pikat 1,2,3,4,5 të Kreut V, VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë pezullimin dhe lirim”, pikat 50,51,52, Urdhri i MF nr. 47, datë 30.06.2015 “Për procedurat e mbylljes së llogarive të njësisve të qeverisjes vendore që do të shkrihen”, Udhëzimin e përbashkët të Ministrit për çështjet vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237, datë 16.07.2015 “Për procedurat,afatet kohore,standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorial” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet 160 -167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave vendore, të marrë masa për kryerjen e inventarizimit dhe marrjen me procesverbal të dokumenteve të bizneseve si dosjet e bizneseve me ngarkesat e detyrimeve përkatëse, regjistrat e tatim paguesve, pasqyrën e debitorëve të krijuar sipas viteve, të ish Komunave Hajmel dhe Bushat, aktualisht Njësi Administrative të Bashkisë Vau-Dejës.

Menjëherë

5.Gjetje nga auditimi: Nga administrata tatimore e bashkisë, për detyrimet të cilat nuk janë paguar në afatet e përcaktuara në ligj dhe në Vendimet e Këshillit Bashkiak, nuk është llogaritur dhe arkëtuar gjoba prej 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar gjendje 31.12.2016, në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 114, pika 1, nga përlllogaritjet e kryera rezulton, (detyrimi 27,726,000 lekë *0.06% * 365 ditë= 6,071,994 lekë) me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Vau-Dejës, në vlerën 6,071,994 lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet 162 -164 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave vendore Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa për të saktësuar, ri llogaritur dhe arkëtuar gjobën kamat vonesën prej 0.06% për qind të shumës së detyrimit të papaguar në vlerën 6,071,994 lekë, sipas listave që ndodhen në zyrën e taksave dhe tarifave vendore.

Menjëherë

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i taksave dhe tarifave vendore rezultoi se, për vitin 2016, programi i të ardhurave nga tatimet taksat dhe tarifave vendore, është miratuar në vlerën 162,000 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 89,241 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 72,755 mijë lekë, ose 55%. Për vitin 2017, programi i të ardhurave nga tatimet taksat dhe tarifave vendore, është miratuar në vlerën 153,000 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 82,514 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 70,486 mijë lekë, ose 54%. Realizimi i të ardhurave është në nivele të ultë, për të dy vitet.

Të dhënat e mësipërme flasin për një performancë jo të mirë të nivelit të arkëtimeve nga Drejtoria e Tarifave Vendore Bashkia Vau Dejës.

Megjithëse janë aplikuar masat shtrënguese për arkëtimin e detyrimeve debitorë të taksave për bizneset gjendje me 31.12.2016 janë në vlerën 9,174 mijë lekë nga 118 subjekte, me 31.12.2017 janë në vlerën 24,155 mijë lekë nga 218 subjekte.

Detyrimet debitorë të taksave dhe tarifave familjare gjendje më 31.12.2017 janë në vlerën 3,571 mijë lekë nga 835 familje, sipas listave që ndodhen në zyrën e taksave vendore, në shkelje të ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet 161 -164 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e të ardhurave vendore Bashkia Vau Dejës, të marrë masa për kryerjen e akt rakordimeve për debitorët e taksave gjendje më 31.12.2017 dhe pasqyrimin në kontabilitet të debitorëve , në vlerën 24,155 mijë lekë nga 218 subjekte.

Për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, nga Zyra e Taksave Bashkia Vau Dejës të nxirren njoftim vlerësimit tatimore duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a-T’u dërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b-T’i dërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesat për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të llogariten kamat vonesat, në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë (gjobë) bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në R.SH”, të ndryshuar, me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014.

d- Për subjektet që nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Bashkisë Vau Dejës, Zyra e Taksave dhe Drejtoria Juridike, të marrë masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhej kallëzim penal sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008” ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014.

Menjëherë

7.Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Vau-Dejës, Drejtoria e të Ardhurave, nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Shkodër. Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI i ka dërguar Bashkisë Vau-Dejës, konstatohet se deri më 31.12.2017, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 67 persona për sipërfaqe ndërtimore gjithsej 16,179 m² nga të cilat 10,747 m² për banim, 2,914 m² për social ekonomike dhe 1,258 m² e kombinuar, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar dhe Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr.3, datë 20.02.2016, nr.61, datë 30.12.2016 dhe nr. 7, datë 24.02.2017, sipas aneksit nr.5/7 me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vau-Dejës në vlerën 2,789,491 lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet 147 -148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në Bashkinë Vau Dejës, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar të marrë masat për arkëtimin e detyrimeve tatimore duke bërë njoftim vlerësimit tatimore për subjektet sipas aneksit nr.5/7, në vlerën totale të pa arkëtuar prej 2,789,491 lekë, e ardhur e munguar nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore të legalizuara.

Menjëherë

8.Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Vau Dejës, ish Bashkinë Vau Dejës dhe ish komuna Bushat, u konstatua se nuk janë ndjekur procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor, për subjektet e pajisura me leje minerare apo koncesionare nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për pasojë nuk janë lidhur kontrata dypalëshe, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i

ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kulloror”, pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, VKM nr. 1353, datë 10.10. 2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, VKM nr. 1374, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kulloror”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016 dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6.1 dhe pika 9.2.3.4, sipas aneksit nr.5/1 me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Vau Dejës, në vlerën 46,401,000 lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet 153 -154 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Bashkia Vau Dejës nëpërmjet strukturave të saj si Drejtoria e të Ardhurave, në bashkëpunim me zyrën Juridike dhe sektorin e menaxhimit të pyjeve e kullotave, që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kulloror këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorore të mbetura.

Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme dhe kryerjen e pagesës së detyrimeve nga dëmtimi i fondit pyjor/kulloror dhe lidhjen e kontratave të qirave për të ardhurat e munguara në vlerën 46,401,000 lekë, të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë, sipas aneksit nr. 5.1, bashkëngjitur Projekt raportit të Auditimit.

Menjëherë

9.Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Vau-Dejës, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Menaxhimit të Territorit, sektori i Urbanistik dhe Menaxhimi i Territorit, nuk është vepruar për të vendosur gjoba, subjekteve që kanë shkelur afatin e fillimit dhe përfundimit të punimeve të ndërtimit dhe që shfrytëzojnë dhe e përdorin objektin pa marrë certifikatën e përdorimit, për objektet e pajisura me leje ndërtimi ne periudha kohore të mëparshme, në shkelje të nenit 52, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, sipas aneksit nr. 6/2 me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë në vlerën 56,000,000 lekë, përkatësisht:

Ish Bashkia Vau i Dejës vlera 5,500,000 lekë, për 11 raste,

Ish Komuna Bushat vlera 50,500,000 lekë, për 101 raste (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet 169 -175 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Menaxhimit të Territorit, sektori i Urbanistik dhe Menaxhimi i Territorit, të marrë masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të vendosur sanksionet ligjore dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 56,000,000 lekë, sipas aneksit nr.6/2 bashkëngjitur, duke kryer inspektime në terren për secilin objekt ndërtimi dhe mbajtjen e akteve përkatëse. E njëjta procedurë të realizohet për të gjitha objektet të cilat kanë shkelur afatet e lejeve të ndërtimit dhe objektet të cilat kanë përfunduar në afat, duke vënë në përdorim objektin pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

Brenda datës 30/11/2018

10.Gjetje nga auditimi: Nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Vau-Dejës, nuk është vepruar për të aplikuar gjoba subjekteve persona fizik dhe juridik, për shkeljet e konstatuara në kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi dhe të dokumentuara me proces verbale konstatimi, ku vendimi i pezullimit të punimeve në ndërtim shoqërohet me vendimin për dënim me gjobë, ku vlera e gjobës përcaktohet bazuar në vlerën e punimeve të kryera pa leje ndërtimi, por për çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, neni 52,

pika 1, germa “e”, ku citohet: “Kryerje e punimeve pa leje, dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve, të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera”, dhe ligjit 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", të ndryshuar”, neni 5 germa “b” ku citohet: “Vendos gjoba sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës”, sipas aneksit nr.6/3, me pasojë, të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, në vlerën 450,000 lekë, për 9 raste (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet 176-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1.Rekomandimi: Bashkia Vau Dejës, zyra e IMTV, për shkeljet e konstatuara nga kundërvajtësit në kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, të marrë masa për vendosjen e gjobave në vlerën 450,000 lekë, sipas aneksit nr.6/3 bashkëngjitur, për shkeljet e konstatuara në kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Menjëherë

11.Gjetje nga auditimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, për periudhën 2016-2017 ka marrë 64 vendime me gjoba, në vlerën prej 15,630,000 lekë, janë arkëtuar vlera 4,130,000 lekë dhe mbeten për tu arkëtuar vlera prej 11,500,000 lekë. Gjobat e vendosura kanë rezultuar si për subjektet juridike e fizike të cilat janë ndërtime pa leje, për individë të ndryshëm të cilët kanë ndërtuar pa leje të autoritetit përgjegjës, Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Menaxhimit të Territorit.. Niveli i përcaktimit të gjobës, përta i përket vlerës nuk është bërë mbi bazën e përlllogaritjes së vlerës së investimit, veprime jo në përputhje me kërkesat e të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, neni 52, pika 1, germa “e”, ku citohet: “Kryerje e punimeve pa leje, dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve, të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera”, dhe ligjit 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", të ndryshuar”, neni 5 germa “b” ku citohet: “Vendos gjoba sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet 177 – 180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, për çdo rast të vendimmarrjes me gjobë duhet të përlllogarisë masën/nivelin e gjobës mbi bazën e vlerës së investimit në rastin e ndërtimit pa leje, ndërsa në rastet e shkeljeve të afatit të lejes apo vënies në përdorim të objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi, në referim dhe të qëllimit të përdorimit/destinacionet të objektit, duke vendosur sanksione maksimale për objektet me karakter shërbimi, banimi etj., kryesisht të ndërtuara nga subjekte juridike dhe sanksione më minimale për objektet individuale (banesa vetjake).

Menjëherë

12- Gjetje nga auditimi: Bashkia Vau-Dejës, ka dërguar në Ministrinë e Financave deklaratën, pyetësorin dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, pa informacionin e Drejtorive vartëse, ndërsa sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, në kundërshtim me pikën 15, germa b, të UMF nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet 24 -28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1-Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës të marrë masa, të dërgoj në Ministrinë e Financave deklaratën, pyetësorin dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe informacionin e Drejtorive vartëse.

Në vijimësi

13- Gjetje nga auditimi: Nga Zyra e Financës në Bashkinë Vau-Dejës, konstatohet se janë detyrimet të prapambetur dhe vijues të paraqitura në bilancin e vitit 2017, për blerje mallra e materiale të ndryshme si dhe punime të kryera për investime të cilat nuk i ka shlyer në vlerën **140,083,084 lekë**, veprim në papajtueshmëri me shkronjën “gj”neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet 40 -42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1- Rekomandim: Zyra e Financës në Bashkinë Vau-Dejës të marrë masa, për të shlyer detyrimet e faturave të prapambetura brenda afateve ligjore në vlerën **140,083,084 lekë**, duke nxjerrë në çdo rast përgjegjësitë për këto detyrime të shtuara.

Në vijimësi

14- Gjetje nga auditimi: Në auditimin e veprimeve me bankë (ish Komuna Hajmel), u konstatua se janë paguar me vendim gjykate për largim të padrejtë të punonjësve, gjithsej për vlerën **835,488 lekë**. Për këtë proces gjyqësor të humbur, Bashkia Vau Dejës nuk ka analizuar shkaqet e lindjes së tyre dhe të marrë masa ndaj personave përgjegjës, veprim në kundërshtim me pikën 62 dhe 102, të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 09.01.2015 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015”, pika 6.1 ”Vendimet gjyqësore”. *(Më hollësisht trajtuar faqen 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1- Rekomandimi: Bashkia Vau Dejës të analizojë të gjitha proceset gjyqësore të cilat kanë sjellë ndikim negativ në buxhetin e bashkisë, të kërkojë nxjerrjen e përgjegjësisë ligjore ndaj personave shkaktarë të gjendjes, si dhe të ndjekin të gjitha shkallët e gjyqësorit.

Në vijimësi

15- Gjetje nga auditimi: Me integrimin e pasqyrave financiare të njëjësive të shkruara me pasqyrat e veta (të bashkisë qendër), bilanci i konsoliduar, që rregullisht duhet të përfaqësojë bashkimin financiar të Bashkisë Vau-Dejës për vitin paraqiten këto probleme:

1. Paraqiten gabime teknike në pasqyrimin e aktiveve në llogaritë përkatëse, duke u pozicionuar në llogaritë jo të duhura. Kjo ka patur efekt se në përlllogaritjen e normave të amortizimit koficientët janë të ndryshëm, kështu që kjo nuk paraqet një gjendje reale të konsumit të aktiveve.

2. Për shpenzimet në proces, nuk ka analizë se cili objekt është në proces.

3. Po kështu është bërë dhe transferimi i amortizimit përkatës për këtë transferim kapital, duke u pasqyruar në kontabilitetin e institucionit.

4. Nga të gjitha ish komunat përveç Komunës Hajmel, të tjerat nuk i kanë mbajtur rregjistrat e aktive afat gjatë si dhe mungojnë analizat përkatëse të llogarive. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet 56 -58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1- Rekomandimi: Nga njësitë administrative të sillen të dhënat që të vazhdohet plotësimi i regjistratit të aktiveve afat gjatë, bazuar në të dhënat përkatëse. Regjistri duhet të përmbajë: Njësinë Administrative, vendodhjen, personin përgjegjës, llogarinë e amortizimit, llogarinë ekonomike të asetit, vlerën fillestare, përshkrimin, normën e amortizimit, vitin e vënies në punë, njësia, sasia, çmimi për njësi, vlera bruto, amortizimi i akumuluar, vlera e mbetur neto, për vitin që përmban shtesat në sasi dhe vlerë, paksimet në sasi dhe vlerë, amortizimin e vitit.

Në vijimësi

16- Gjetje nga auditimi: -Nga Sektori i Menaxhimit të Aseteve për pronat e transferuara Bashkisë Vau-Dejës, nuk ka bërë rregjistrimin e të gjithë këtyre pronave në ZVRPP, nuk janë inventarizuar, nuk disponohej informacion në lidhje me emrat e personave që i kanë zënë këto prona.

-Nga Sektori i Menaxhimit të Aseteve për pronat e Njesive Administrative, Bushat, Hajmel, Vig Mnele, Shllak, Temal, të cilët me VKM i është miratuar lista paraprake e pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim, nuk është përgatitur

dokumentacioni ligjor sipas kërkesave të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, me qëllim miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, këtyre Njësive Administrative, për vënien në funksion e këtyre aseteve, për plotësimin e nevojave të komunitetit dhe krijimin e të ardhurave nga dhënia me qira e tyre. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet 187 – 188 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1- Rekomandimi: Nga Bashkisë Vau-Dejës dhe Sektori i Menaxhimit të Aseteve të merren masat e duhura, për pronat e transferuara dhe të bëj rregjistrimin e të gjithë këtyre pronave në ZVRPP, të bëj inventarizimin, dhe të siguroj informacionin e duhur në lidhje me emrat e personave që i kanë zënë këto prona.

16.2- Rekomandimi: - Nga Bashkisë Vau-Dejës dhe Sektori i Menaxhimit të Aseteve të merren masat e duhura, për pronat e Njësive Administrative, Bushat, Hajmel, Vig Mnele, Shllak, Temal, të cilët me VKM i është miratuar lista paraprake e pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim, të përgatitet dokumentacioni ligjor sipas kërkesave të VKM nr. 500, datë 14.08.2001.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve teknike të objekteve “Rikualifikim i rrugës Hajmel – Dheu i lehtë –Pistull, Loti i I, Bashkia Vau i Dejës” dhe “Rruga Dejë - Qendër”, Bashkia Vau i Dejës, rezultoi se këto objekte ishin prokuruar dhe zbatuar pa marrë leje ndërtimi, në kundërshtim me Ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet 125 -137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa që, para hedhjes së objekteve në sistemin elektronik të prokurimeve, të ndiqen procedurat e marrjes së lejes së ndërtimi, në mënyrë që objektet të realizohen sipas projektit dhe preventivit të miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim në procedurat e prokurimit të audituara për periudhën objekt auditimi rezultoi se nuk kanë gjetur zbatim aktet ligjore e nënligjore të fushës së prokurimit publik, duke mos i argumentuar këto kërkesanë lidhje të ngushtë me objektin e kontratës, veprim në kundërshtim me nenin 26, pika 5, nenin 61, pika 2, paragrafi i të VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet 79- 127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1. Rekomandim: Autoriteti kontraktor Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa në zbatimin e akteve ligjore e nënligjore të LPP, për përcaktimin e kriterëve të veçanta për kualifikim në përputhje me objektin e prokurimit.

Në vijimësi.

B- MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikualifikim i rrugës Hajmel – Dheu i lehtë –Pistull, Loti i I, Bashkia Vau i Dejës”, me vlerë të kontratës 93,997,386 lekë me tvsh, fituar nga Operatori Ekonomik “Sh. A.” Sh.p.k, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **2,861,838 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 39/10 prot datë 20.07.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Vau i Dejës dhe Operatori Ekonomik “Sh. A.” Sh.p.k *(Më hollësisht trajtuar në faqen 126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,861,838 lekë pa tvsh** nga Operatori Ekonomik “Sh. A.” Sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. nr. 39/10 prot datë 20.07.2017 me objekt “*Rikualifikim i rrugës Hajmel – Dheu i lehtë – Pistull, Loti i I, Bashkia Vau i Dejës*”, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Rruga Dejë - Qendër*”, Bashkia Vau i Dejës, me vlerë të kontratës 50,309,273 lekë me tvsh, fituar nga Operatori Ekonomik “B. 93.” Sh.p.k, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **577,540 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 39/10 prot datë 20.07.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Vau i Dejës dhe OE “B. 93.” Sh.p.k (*Më hollësisht trajtuar në faqen 130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **577,540 lekë pa tvsh** nga OE “B. 93.” Sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 39/10 prot datë 20.07.2017 me objekt “*Rruga Dejë - Qendër*”, Bashkia Vau i Dejës, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt “*Rikualifikim i Qendrës së Qytetit, Faza I*” të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vau-Dejës dhe shoqërisë “J.” SHPK u konstatua se rezultojnë diferenca në volume për punime të kryera të ndërtimit duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë në vlerën **3,218,250 lekë pa TVSH**. (*Më hollësisht trajtuar në faqen 133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Bashkia Vau-Dejës, që t’i kërkojë operatorit ekonomik “J.” SHPK duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **3,218,250 lekë pa TVSH**, të përfituara më tepër për diferenca në volume për punime të kryera inxhinierike duke shkaktuar një dëm ekonomik në zbatimin e kontratës “*Rikualifikim i Qendrës së Qytetit, Faza I*”.

B2. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Vau Dejës, nuk është aplikuar saktë tarifa vendore për pajisen e subjekteve, me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe as nuk janë arkëtuar vlerat për dhënien dhe përsëritjen e licencave, në shkelje të VKM nr.170, datë 25.4.2002 “*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre*”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4 dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*”, i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 10, të trajtuara në aneksit nr.5/3, me pasojë të ardhur të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, në vlerën, në vlerën 5,300,000 lekë (*Më hollësisht trajtuar në faqen 139- 140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Vau Dejës, Drejtoria e të Ardhurave vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **5,300,000 lekë**, për mos arkëtim diferencë tarife për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, sipas aneksit nr.5/3 bashkangjitur Projektraportit të auditimit.

Brenda datës 30/11/2018

2.Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e të Ardhurave vendore Bashkia Vau-Dejës, nuk është aplikuar dhe arkëtuar tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Vau-Dejës dhe Njësive administrative në vartësi, të cilat janë pajisur me leje ndërtimi për objekte të ndryshme private, me fonde jo publike. Nga përlogaritjet e kryera rezulton se për 4 subjekte ndërtimi nuk janë ngarkuar me detyrime për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, në shkelje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës nr.61, datë 30.12.2016, “Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2017”, ndryshuar me vendimin e këshillit të bashkisë nr. 7, datë 24.02.2017, kapitulli II.1, Tarifat, sipas aneksit nr.5/4, me pasojë të ardhur të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, në vlerën 100,000 lekë (*Më hollësisht trajtuar në faqen 141- 142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1.Rekomandimi: Bashkia Vau Dejës, Drejtoria e të Ardhurave, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **100,000 lekë**, për mos aplikim tarife për subjektet që janë pajisur me leje ndërtimi me fonde private, sipas aneksit nr.5/4 bashkangjitur Projekt raportit të auditimit.

Brenda datës 30/11/2018

3. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e të Ardhurave vendore Bashkia Vau-Dejës, nuk është aplikuar dhe arkëtuar tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për çdo vit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Vau-Dejës dhe Njësive administrative në vartësi dhe janë pajisur me leje ndërtimi për objekte të ndryshme, me fonde publike (tendera) përkatësisht:

-për vitin 2016 në vlerën 440,000 lekë

-për vitin 2017 në vlerën 652,500 lekë

nuk janë ngarkuar me detyrime për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, në shkelje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës nr.61, datë 30.12.2016, “Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2017”, ndryshuar me vendimin e këshillit të bashkisë nr. 7, datë 24.02.2017, kapitulli II.1, Tarifave, me pasojë të ardhur të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, sipas aneksit nr.5/5, në vlerën 922,500 lekë (*Më hollësisht trajtuar në faqen 142- 143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Vau Dejës, sektori i taksave dhe tarifave vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **922,500 lekë**, detyrime për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave sipas aneksit nr.5/5 bashkangjitur Projektraportit të auditimit.

Brenda datës 30/11/2018

4.Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e të ardhurave, sektori i taksave dhe tarifave vendore Bashkia Vau Dejës, nuk janë aplikuar saktë detyrimet për taksat dhe tarifave vendore si taksa trualli, taksa ndërtese, tarifa e pastrimit, tarifa e ndriçimit dhe tarifave e gjelbërimit për qëllime biznesi për 6 subjekte që kanë detyrimin për të paguar, në shkelje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreu II, nenit 9, pika 2; neni 21, pika 2; neni 23/1 dhe Vendimeve të Këshillit të Bashkisë nr.3, datë 20.02.2016, “Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2016”, Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.61, datë 30.12.2016, “Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2017”, ndryshuar me vendimin e këshillit të bashkisë nr. 7, datë 24.02.2017, të Bashkisë Vau-Dejës, sipas aneksit nr.5/6, me pasojë të ardhur të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, në vlerën në vlerën 3,235,942 lekë (*Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 145 -146 të Projekt Raportit të Auditimit*).

4.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Vau Dejës, sektori i taksave dhe tarifave vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **3,235,942 lekë**, detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore si taksa trualli, taksa ndërtese, tarifa e pastrimit, tarifa e ndriçimit dhe tarifatat e gjelbërimit për qëllime biznesi, sipas aneksit nr.5/6 bashkangjitur Projektraportit të auditimit.

Brenda datës 30/11/2018

5.Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Vau-Dejës, nuk është arkëtuar detyrimi sipas kontratës së qirasë, për kontratat e lidhur midis Bashkisë Vau i Dejës, ish Bashkisë Vau-Dejës, ish Komunës Vig-Mnel, Temal, Shllak dhe Kompanive të telefonisë celulare, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, sipas aneksit nr.5/2, me pasojë të ardhur të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, në vlerën 7,723,000 lekë, përkatësisht:

Ish Bashkia Vau Dejës vlera 3,073,000 lekë

Ish Komuna Vig-Mnelë 1,650,000 lekë

Ish Komuna Temal vlera 1,500,000 lekë

Ish Komuna Shllak vlera 1,500,000 lekë (Më hollësisht trajtuar në faqen 154-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Vau Dejës, sektori i taksave dhe tarifave vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **7,723,000 lekë**, detyrimet për mos arkëtim qira nga kompanitë e telefonisë celulare, sipas aneksit nr.5/2 bashkangjitur Projekt raportit të auditimit.

Brenda datës 30/11/2018

6.Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Vau Dejës, ish Bashkia Vau Dejës, ish Komuna Bushat, nuk janë zbatuar detyrimet kontratuale për arkëtimin e vlerave të përcaktuara në kontratat e lidhura midis Bashkisë dhe subjekteve private, për pasuritë e dhëna me qira si pyje, kullota dhe toka inproduktive, nuk janë arkëtuar për vlerën e plotë, në shkelje të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, kap VI, pikat 1,2,9,10, sipas aneksit nr.5/8, me pasojë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vau-Dejës në vlerën 16,668,000 lekë (Më hollësisht trajtuar në faqe 154 -155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me sektorin e pyjeve e kullotave, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **16,668,000 lekë**, detyrimet për mos arkëtim nga dhëna me qira pyje, kullota dhe toka inproduktive, sipas aneksit nr.5/8 bashkangjitur Projektraportit të auditimit.

Brenda datës 30/11/2018

7.Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Vau Dejës, ish Bashkia Vau Dejës, ish Komuna Vig-Mnel, nuk janë zbatuar detyrimet kontratuale për arkëtimin e vlerave të përcaktuara në kontratat e lidhura midis Bashkisë dhe subjekteve private, për pasuritë e dhëna me qira ndërtesa etj, nuk janë arkëtuar për vlerën e plotë, në shkelje të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, kap VI, pikat 1,2,9,10, sipas aneksit nr.5/9, me

pasojë të ardhur të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, në vlerën **70,833 lekë** (Më hollësisht trajtuar në faqen 158- 159 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Vau Dejës, sektori i taksave dhe tarifave vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **70,833 lekë**, detyrimet për mos arkëtim nga dhëna me qira për pasuritë ndërtesa etj, sipas aneksit nr.5/9 bashkangjitur Projektraportit të auditimit.

Brenda datës 30/11/2018

8.Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Menaxhimit të Territorit, sektori Urbanistik dhe Menaxhimi i Territorit, Bashkia Vau-Dejës nuk është llogaritur saktë taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, nuk është kryer përlllogaritja në bazë të çmimit referencë që është kosto mesatare e ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave, në shkelje të ligjit nr. nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar neni 46, Udhëzimi KM nr.3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2016” dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.61, datë 30.12.2016, “Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2017”, ndryshuar me vendimin e këshillit të bashkisë nr. 7, datë 24.02.2017, sipas aneksit nr. 6/1, me pasojë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, në vlerën 561,215 lekë (Më hollësisht trajtuar në faqen 175 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Vau Dejës, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Menaxhimit të Territorit, sektori Urbanistik dhe Menaxhimi i Territorit, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **561,215 lekë**, detyrimet për mos arkëtim takse të ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, sipas aneksit nr.6/1 bashkangjitur Projektraportit të auditimit.

Brenda datës 30/11/2018

9.Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Vau-Dejës, nuk janë zbatuar detyrimet kontratuale, nuk është arkëtuar detyrimi sipas kontratave tip të qirave të tokave bujqësore të pandara të lidhur midis ish Bashkisë Vau-Dejës, ish Komunës Bushat dhe personave fizik qiramarrës, gjithashtu nuk janë përlllogaritur kamat vonesat përkatëse për çdo ditë vonesë për mos arkëtimin në kohë të detyrimeve, veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 531, datë 21.8.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, i ndryshuar, UKM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, kreu V, pika 1,2,4,5, sipas aneksit nr. 7/1, me pasojë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, në vlerën 496,522 lekë. (detyrim vlera 451,384 lekë, kamat vonesë 45,138 lekë) (Më hollësisht trajtuar në faqen 190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Vau Dejës, Drejtoria e Bujqësisë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **496,522 lekë**, detyrimet për mos arkëtim qira të tokave bujqësore, sipas aneksit nr.7/1 bashkangjitur Projektraportit të auditimit.

Brenda datës 30/11/2018

B/3. MASA PËR ELEMNIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se:

- Zëri “Shkallmim shtrese ekzistuese asfaltike + transport, sipas profileve tërthore” është llogaritur me një shifër 5492 m². Ky zë pune është zëri i manualit me analizë An. “Skarifikim

shtrese asfalti me makineri” dhe çmimi i tij duhej marrë nga manuali në fuqi i çmimeve të punimeve të ndërtimit, viti 2015, në të cilin ky çmim është 190 lekë/m². Nga rillogaritja, vlera e këtij zëri pune është 1,043,480 lekë, ose **631,580 lekë më shumë** se ajo e paraqitur në preventivin e punimeve, vlerë e cila përbën rritje fiktive të fondit limit.

- Zëri “Mbushje, përhapje dhe ngjeshje me zhavorr në trupin e rrugës dhe për seksionet ku është hequr toka vegjetale” është llogaritur me një shifër 5492 m². Ky zë pune, edhe pas pretendimit të përfaqësuesit të projektuesit, nuk është i argumentuar. Nga shqyrtimi i projektit të zbatimit, konstatohet se në specifikimet teknike të projektuesit se në kapitullin pika 2.3/a “Gërmimi”, është përcaktuar që *“Për çdo thellësi më të madhe të gërmuar nën nivelin e formacionit, brenda tolerancës së lejuar, duhet të bëhet mirë me mbushje me materiale të pranueshme me karakteristika të ngjashme nga sipërmarrësi, me shpenzimet e tij”*. Për pasojë, volumi prej 2520 m³ për seksionet ku është hequr toka vegjetale, është i paargumentuar teknikisht dhe vlera prej **3,426,720 lekë**, përbën rritje fiktive të fondit limit. Në total, fondi limit është rritur fiktivisht me **4,058,300 lekë**, vlerë që përbën shpenzime pa ekonomikitet të fondeve të njësisë vendore (Më hollësisht trajtuar në faqet 124 -1125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi

Autoriteti Kontraktor Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa nëpërmjet strukturave të prokurimit, që para publikimit të procedurës së prokurimit, të kontrollojë dhe analizojë projektpreventivin, në mënyrë që fondi limit të jetë teknikisht i argumentuar, konform projektit dhe sa më afër kostos reale të zbatimit.

Menjëherë

2- Gjetje nga auditimi:

Ish Komuna Hajmel

Në tetë raste, blerje me vlera të vogël, vlera në total prej 1,487,666 lekë, përbën shkelje të disiplinës financiare me efekte negative për buxhetin e ish-Komunës Hajmel.

Ish Komuna Shllak

Në gjashtë raste, blerje me vlera të vogla, vlera në total prej 1,011,052 lekë përbën shkelje të disiplinës financiare me efekte negative për buxhetin e ish-Komunës Shllak.

Ish Komuna Temal

Në gjashtë raste, blerje me vlera të vogla, vlera në total prej 1,436,828 lekë, përbën shkelje të disiplinës financiare me efekte negative për buxhetin e ish-Komunës Temal.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 68-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1- Rekomandimi: Bashkia Vau i dejës të marrë masa që në zbatimin e procedurave të blerjeve me vlera të vogla të zbatojë aktet nënligjore të prokurimit publik, në lidhje me blerjet e vogla.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, geramat (b, c, ç) e nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronjën “k” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, pranë Institucionit Tuaj marrjen e masës disiplinore, **për 13 punonjës**, si më poshtë:

C/1 “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 germa (b, c)

1.zj. M. Gj. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së të Ardhurave

2.z.D. P., me detyrë Specialist i Sektorit të të Ardhurave,

3.z.N. K., me detyrë Specialist i Sektorit të të Ardhurave,

4.zj.E. N., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të të Ardhurave,

Për shkeljet e mëposhtëme:

-Nuk kanë plotësuar njoftimet e detyrimit, nuk u janë dërguar në rrugë postare të gjithë subjekteve tatimpagues, që kanë detyrimin ligjor për të paguar, taksat dhe tarifave vendore si, për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, tarifën e ndriçimit, tarifën e gjelbërimit, taksën e tabelës dhe për taksën mbi ndërtesat dhe për pasojë nuk janë arkëtuar detyrimet ligjore nga subjektet taksapagues, veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 23, pika 2.

-Nuk është bërë miradministrimi i informacionit tatimor, të subjekteve tatimpagues të Biznesit të Vogël, për të gjitha detyrimet tatimore dhe nuk janë vendosur në dosjen e çdo tatim paguesi, ka mangësi përditësimi të të dhënave dhe mungesë të dokumentacionit, ku regjistrohen të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit, veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim, me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 29, pika 1.

-Nuk është vepruar për inventarizimin e dokumentacionit që ndodheshin në dosjet e subjekteve taksapagues të taksave dhe tarifave vendore ku nga auditimi u konstatuan me mangësi si të gjitha praktikant nuk shoqërohen me fletë inventari për numrin dhe llojin e dokumenteve dhe shkresave që përmban një dosje e subjektit, i gjithë dokumentacioni i subjektit mbahet në një dosje qysh nga krijimi i subjektit për disa vite me radhë, praktikant e përfunduara të viteve të mëparshëm nuk janë dorëzuar në arkivin e institucionit, në kundërshtim, me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” neni 24, dhe me Rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, kapitulli II, nenet 21,27.

-Për detyrimet të cilat nuk janë paguar në afatet e përcaktuara në ligj dhe në Vendimet e Këshillit Bashkiak, nuk është llogaritur dhe arkëtuar gjoba prej 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar gjendje 31.12.2016, në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 114, pika 1, nga përlllogaritjet e kryera rezulton, (detyrimi 27,726,000 lekë *0.06% * 365 ditë= 6,071,994 lekë) me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Vau-Dejës, në vlerën 6,071,994 lekë.

-Nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Shkodër. Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI i ka dërguar Bashkisë Vau-Dejës, konstatohet se deri më 31.12.2017, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 67 persona për sipërfaqe ndërtimore gjithsej 16,179 m² nga të cilat 10,747 m² për banim, 2,914 m² për social ekonomike dhe 1,258 m² e kombinuar, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar dhe Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr.3, datë 20.02.2016, nr.61, datë 30.12.2016 dhe nr. 7, datë 24.02.2017,

sipas aneksit nr.5/7 me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vau-Dejës në vlerën 2,789,491 lekë.

-Nuk janë ndjekur procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor, për subjektet e pajisura me leje minerare apo koncesionare nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për pasojë nuk janë lidhur kontrata dypalëshe, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor”, pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, VKM nr. 1353, datë 10.10. 2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, VKM nr. 1374, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016 dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6.1 dhe pika 9.2.3.4, sipas aneksit nr.5/1 me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Vau Dejës, në vlerën 46,401,000 lekë.

-Nuk është aplikuar saktë tarifa vendore për pajisen e subjekteve, me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe as nuk janë arkëtuar vlerat për dhënien dhe përsëritjen e licencave, në shkelje të VKM nr.170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4 dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 10, të trajtuara në aneksit nr.5/3, me pasojë dëmin ekonomik për buxhetin e bashkisë, në vlerën 5,300,000 lekë.

-Nuk është aplikuar dhe arkëtuar tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Vau-Dejës dhe Njësive administrative në vartësi, të cilat janë pajisur me leje ndërtimi për objekte të ndryshme private, me fonde jo publike. Nga përlloraritjet e kryera rezulton se për 4 subjekte ndërtimi nuk janë ngarkuar me detyrime për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, në shkelje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës nr.61, datë 30.12.2016, “Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2017”, ndryshuar me vendimin e këshillit të bashkisë nr. 7, datë 24.02.2017, kapitulli II.1, Tarifave, sipas aneksit nr.5/4, me pasojë dëmin ekonomik për buxhetin e bashkisë Vau-Dejës, në vlerën 100,000 lekë.

-Nuk është aplikuar dhe arkëtuar tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për çdo vit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Vau-Dejës dhe Njësive administrative në vartësi dhe janë pajisur me leje ndërtimi për objekte të ndryshme, me fonde publike (tendera) përkatësisht:

-për vitin 2016 në vlerën 440,000 lekë, -për vitin 2017 në vlerën 652,500 lekë, nuk janë ngarkuar me detyrime për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, në shkelje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës nr.61, datë 30.12.2016, “Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2017”, ndryshuar me vendimin e këshillit të bashkisë nr. 7, datë 24.02.2017, kapitulli II.1, Tarifave, me pasojë dëmin ekonomik për buxhetin e bashkisë Vau-Dejës, sipas aneksit nr.5/5, në vlerën 922,500 lekë.

-Nuk janë aplikuar saktë detyrimet për taksat dhe tarifave vendore si taksa trualli, taksa ndërtese, tarifa e pastrimit, tarifa e ndriçimit dhe tarifave e gjelbërimit për qëllime biznesi për

6 subjekte që kanë detyrimin për të paguar, në shkelje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreu II, nenit 9, pika 2; neni 21, pika 2; neni 23/1 dhe Vendimeve të Këshillit të Bashkisë nr.3, datë 20.02.2016, “Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2016”, Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.61, datë 30.12.2016, “Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2017”, ndryshuar me vendimin e këshillit të bashkisë nr. 7, datë 24.02.2017, të Bashkisë Vau-Dejës, sipas aneksit nr.5/6, me pasojë dëmin ekonomik për buxhetin e bashkisë, Vau-Dejës në vlerën 3,235,942 lekë.

-Nuk është arkëtuar detyrimi sipas kontratës së qirasë, për kontratat e lidhur midis Bashkisë Vau i Dejës, ish Bashkisë Vau-Dejës, ish Komunës Vig-Mnel, Temal, Shllak dhe Kompanive të telefonisë celulare, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, sipas aneksit nr.5/2, me pasojë, dëm ekonomik në Buxhetin e Bashkisë në vlerën 7,723,000 lekë, përkatësisht:

Ish Bashkia Vau Dejës vlera 3,073,000 lekë

Ish Komuna Vig-Mnelë 1,650,000 lekë

Ish Komuna Temal vlera 1,500,000 lekë

Ish Komuna Shllak vlera 1,500,000 lekë

-Nuk janë zbatuar detyrimet kontratuale për arkëtimin e vlerave të përcaktuara në kontratat e lidhura midis Bashkisë dhe subjekteve private, për pasuritë e dhëna me qira si pyje, kullota dhe toka inproduktive, nuk janë arkëtuar për vlerën e plotë, në shkelje të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, kap VI, pikat 1,2,9,10, sipas aneksit nr.5/8, me pasojë, dëm ekonomik në Buxhetin e Bashkisë Vau-Dejës në vlerën 16,668,000 lekë.

C/2 “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”deri në largim nga shërbimi civil, neni 58 germa (c,c)

5.z.M. S., me detyrë Inspektor Menaxhim Pyje Kullota.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Nuk kanë ndjekur procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor, për subjektet e pajisura me leje minerare apo koncesionare nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për pasojë nuk janë lidhur kontrata dypalëshe, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor”, pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, VKM nr. 1353, datë 10.10. 2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, VKM nr. 1374, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016 dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6.1 dhe pika 9.2.3.4, sipas aneksit nr.5/1 me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Vau Dejës, në vlerën 46,401,000 lekë.

-Nuk kanë arkëtuar detyrimet sipas kontratës së qirasë, për kontratat e lidhur midis Bashkisë Vau i Dejës, ish Bashkisë Vau-Dejës, ish Komunës Vig-Mnel, Temal, Shllak dhe Kompanive të telefonisë celulare, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 391,

datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, sipas aneksit nr.5/2, me pasojë, *dëm ekonomik në Buxhetin e Bashkisë në vlerën 7,723,000 lekë, përkatësisht:*

Ish Bashkia Vau Dejës vlera 3,073,000 lekë

Ish Komuna Vig-Mnelë 1,650,000 lekë

Ish Komuna Temal vlera 1,500,000 lekë

Ish Komuna Shllak vlera 1,500,000 lekë

-Nuk kanë zbatuar detyrimet kontratuale për arkëtimin e vlerave të përcaktuara në kontratat e lidhura midis Bashkisë dhe subjekteve private, për pasuritë e dhëna me qira si pyje, kullota dhe toka inproduktive, nuk janë arkëtuar për vlerën e plotë, në shkelje të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, kap VI, pikat 1,2,9,10, sipas aneksit nr.5/8, *me pasojë, dëm ekonomik në Buxhetin e Bashkisë Vau-Dejës në vlerën 16,668,000 lekë.*

6.z.I. G. me detyrë, Drejtor i Planifikimit Urban dhe Menaxhimit të Territorit, sektori i Urbanistik dhe Menaxhimi i Territorit.

7.znj.A. Sh., me detyrë, Specialiste Urbanistike në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Menaxhimit të Territorit,

8.znj.J. M., me detyrë, Specialiste Urbanistike në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Menaxhimit të Territorit,

9.znj.O. Y., me detyrë, Specialiste Urbanistike në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Menaxhimit të Territorit,

Për shkeljet e mëposhtme:

-Nuk kanë vepruar për të vendosur gjoba, subjekteve që kanë shkelur afatin e fillimit dhe përfundimit të punimeve të ndërtimit dhe që shfrytëzojnë dhe e përdorin objektin pa marrë certifikatën e përdorimit, për objektet e pajisura me leje ndërtimi ne periudha kohore të mëparshme, në shkelje të nenit 52, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, sipas aneksit nr. 6/2 me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë në vlerën 56,000,000 lekë, përkatësisht:

Ish Bashkia Vau i Dejës vlera 5,500,000 lekë, për 11 raste,

Ish Komuna Bushat vlera 50,500,000 lekë, për 101 raste.

-Nuk kanë llogaritur saktë taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, nuk është kryer përlllogaritja në bazë të çmimit referencë që është kosto mesatare e ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave, në shkelje të ligjit nr. nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar neni 46, Udhëzimi KM nr.3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2016” dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.61, datë 30.12.2016, “Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2017”, ndryshuar me vendimin e këshillit të bashkisë nr. 7, datë 24.02.2017, sipas aneksit nr. 6/1, me pasojë dëmin ekonomik në total në vlerën 561,215 lekë.

C/3. Për 4 **punonjësit** e mëposhtëm që përmenden me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk mund të propozojmë masë disiplinore pasi pavarësisht disa mangësive e të trajtuara, ato nuk përmbushin kushtet për dhënie mase disiplinore, respektivisht kjo për punonjësit:

1.z.M. L., me detyrë, Kryeinspektor i Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit Vendor.

2.z.A. A., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Bujqësisë, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës,

3.z.A. G., me detyrë specialist bujqësie, ujitje kullim i Sektorit të Bujqësisë, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës,

4.z.J. P., me detyrë specialist Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës,

C/4. Për 12 **ish-punonjësit** e larguar nga detyra dhe që nuk kanë adresim institucional pasi kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me institucionin, dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre por që atakohen me Raportin Përfundimtar të Auditimit, propozimi i masave disiplinore quhet i ezauruar, respektivisht:

Ish Bashkia Vau i Dejës

1.z. Gj. B. me detyrë ish Përgjegjës i Zyrës së Aseteve

2.z. R. G., me detyrë ish Përgjegjëse i Sektorit të Aseteve dhe Pronave

3.z.L. I., me detyrë Inspektor e Sektorit të Aseteve dhe Pronave

Ish Komuna Shllak

4.z. H. K. me detyrë, ish Kryetar i Komunës Shllak,

5.znj. K. Sh. me detyrë ish Përgjegjëse e Zyrës së Financës

6.z.K. B., me detyrë ish Inspektor i Tatim Taksave,

Ish Komuna Temal

7.z. M. Zh. me detyrë, ish Kryetar i Komunës Temal,

8.z. Gj. G. me detyrë ish Përgjegjës i Zyrës së Financës

9.z.L. M., me detyrë ish Inspektor i Tatim Taksave,

Ish Komuna Vig-Mnelë

10.z. P. Ll. me detyrë, ish Kryetar i Komunës Vig-Mnelë,

Ish Komuna Bushat

11.z. R. G., me detyrë ish Përgjegjëse i Sektorit të Aseteve dhe Pronave

12.z.L. I., me detyrë ish Inspektor e Sektorit të Aseteve dhe Pronave

D. MASA ADMINISTRATIVE:

D/1- PËR INSPEKTORIATIN E MROJTJES TERITORIT TË BASHKISË VAU I DEJËS:

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobë për një mbikëqyrës, një projektues dhe dy kolaudatorë punimesh**, si më poshtë:

1. **Z. I. D.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektet: “Rikualifikim i rrugës Hajmel – Dheu i lehtë –Pistull, Loti i I, Bashkia Vau i Dejës”, me sipërmarrës punimesh OE “Sh. A.” Sh.p.k, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 2,861,838 lekë pa tvsh dhe “Rruga Dejë - Qendër”, Bashkia Vau i Dejës me sipërmarrës punimesh OE “B. 9.” Sh.p.k, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 577,540 lekë pa tvsh, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

2. **Z. N. B.**, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: “Rikualifikim i rrugës Hajmel – Dheu i lehtë –Pistull, Loti i I, Bashkia Vau i Dejës”, me sipërmarrës punimesh OE “*Sh. A.*” *Sh.p.k*, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 2,861,838 lekë pa tvsh, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt

3. **Z. E. M.**, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: “*Rruga Dejë - Qendër*”, *Bashkia Vau i Dejës* me sipërmarrës punimesh OE “*B.9.*” *Sh.p.k*, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 577,540 lekë pa tvsh, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

4. **Znj. F. K.**, në cilësinë e përfaqësuesit të projektuesit “I.” shpk, për shkeljet e konstatuara në projektimin e objektit: “Rikualifikim i rrugës Hajmel – Dheu i lehtë –Pistull, Loti i I, Bashkia Vau i Dejës”, me pasojë rritjen fiktive të vlerës së objektit në shumën 4,058,300 lekë.

D/2 PËR PËRMIRËSIMIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK.

Referuar procedurave të prokurimit publik të zhvilluara në Bashkinë Vau i Dejës, kualifikimit të drejtë të operatorëve ekonomike si dhe disa mangësive të konstatuara në hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim, në procedurat e audituara nga grupi i auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, **i rekomandojmë** Titullarit të Autoritetit Kontraktor: të marrë masa për përmirësimin e mëtejshëm të Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, në drejtim të përcaktimit të kërkesave të veçanta për kualifikim në lidhje të ngushte me objektin e procedurës së prokurimit. Njëherazi për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit publik **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës në bashkërendim me Këshillin Bashkiak të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit të trajtuara më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R